

RAMAZANI

CILA ËSHTË POENTA?



IBRAHIM SEKRAN

Ramazani - cila është poenta?

Ibrahim Sekrani

Prishtinë, 2021 / 1442 b

Titulli:

Ramazani - cila është poenta?

Titulli në arabisht:

المغزى الرمضاني

(El Magza er Ramadani)

Autor:

Ibrahim Sekrani

Përktheu nga gjuha arabe:

Kushtrim Manxhuka

Redaktor gjuhësor:

Klodiana Smajlaj

Ballina:

Fatlum Zeka

Boton:



@Ibrahim.Sekrani

Të gjitha të drejtat e botimit janë të rezervuara për faqen:

@Ibrahim.Sekrani.

Prishtinë, 2021 / 1442 h

RAMAZANI - CILA ËSHTË POENTA?

IBRAHIM SEKRANI

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Me emrin e Allahut, të
Ejithëmëshihshorit, Mëshirëplotit!*

Takimi i parë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi më fisnikun e peygamberëve dhe të dërguarve, Muhamedin, Peygamberin tonë, si dhe mbi familjen e shokët e tij!

Qofshi të mirëseardhur, vëllezër!

Siç e dini, vetëm disa net na ndajnë nga muaji Ramazan. Kur njeriu është duke pritur një vizitor të shtrenjtë, zemra e tij fillon të preokupohet me të para se ai të arrijë. Nuk na ka hije që ky muaj të na afrohet e t'i gjejë zemrat tona në luginën e ftohtë të shpërfilljes. Zakonisht, kjo ndodh për shkak të hutisë së madhe që e mbulon zemrën, e si pasojë, njeriu nuk e ndien ardhjen e këtij muaji të madhërishtëm. Kurse zemrave të gjalla, afshi i mallëngjimit për muajin Ramazan, vetëm se ua shton edhe më shumë zjarrin e përmallimit. Prandaj, në disa takime me radhë, ne do të flasim për disa kuptime dhe domethënie të muajit Ramazan.

Prej këtyre kuptimeve, të parin që do të përmendim, mund ta quajmë:

Amnistia vjetore

Vetë kujtimet e Ramazanit të kaluar flasin për atë që njeriu ka në mendje. Ta zëmë se dikujt i është shkruar të ketë ymër edhe gjatë këtij Ramazani, nga i cili na ndajnë vetëm pak ditë. Vallë sa e sa gabime kemi bërë dhe sa e sa herë kemi veshur turpin e shpërfilljes gjatë këtij viti, i cili ndau këtë Ramazan me të kaluarin? Pash Allahun, kujto se sa herë ke dëgjuar diçka të ndaluar e sa shikime i ke çuar në haram? Sa e sa fjalë të ndaluara janë regjistruar në fletushkat e veprave tona! E gjithë kjo përgjatë vitit që shkoi! Kundrejt kësaj, Zoti i Lartësuar Bujar na i hap dyert e amnistisë vjetore. Për çdo vit, ne kemi një takim me këtë amnisti, një mundësi kjo për fshirjen e fletushkave, çka nuk mund të zëvendësohet me asgjë.

Në përmbledhjen e tij autentike, Imam Muslim ibn Haxhaxhi përcjell hadithin e Ebu Hurejrës (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), i cili transmeton se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Pesë namazet, xhumaja deri në xhumanë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër, janë falje për mëkatet e bëra mes tyre, nëse njeriu rubet prej mëkateve të mëdha.”* Pra, çdo gjë, qoftë mëkat i vogël ose shkarje, është e shkruar. Njeriu, disa prej tyre i mban mend, por shumicën i harron. Megjithatë, ato ndodhen në një “Libër”, të cilin Allahu i Lartësuar e përshkruan (me fjalët e robërve): **“... Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar...”**. (*Kehf, 49*)

Allahu na e hap derën e kësaj amnistie madhështore. Ai na i fshin të gjitha këto shkarje dhe mëkate të vogla. Pra, Ramazani është pastrim për shpirtin nga plagët e një viti të tërë, siç ka thënë Pejgamberi ﷺ: *“Ramazani deri në Ramazanin tjetër i fshin mëkatet e vitit të shkuar, nëse njeriu ruhet nga mëkatet e mëdha.”*

Dikush mund të thotë se i Dërguari ﷺ në këtë hadith përmend:

1 – Amnistinë ditore, kur thotë: *“Pesë namazet...”*;

si dhe

2 – Amnistinë javore, kur thotë: *“E xhumaja deri në xhumanë tjetër...”*.

Nëse pesë namazet i fshijnë mëkatet mes tyre, atëherë çfarë i mbetet amnistisë javore, nga xhumaja deri në xhumanë tjetër? Njashtu, nëse pesë namazet i fshijnë mëkatet (gjegjesisht aministia ditore) dhe e xhumaja deri në xhumanë tjetër i fshin po ashtu ato (gjegjesisht aministia javore), atëherë çfarë i mbetet amnistisë vjetore të Ramazanit? Pra, a mund të themi se kjo amnisti e Ramazanit nuk do të ketë efekt?

Përgjigjja është: Jo. Kjo përgjigje është e lidhur me një parim të përgjithshëm fetar, i cili thotë se:

- pasoja vjen në përputhje me veprën;
- efektet, rezultatet dhe pasojat e fjalëve dhe veprave të lavdëruara apo të nënçmuara në fe, shfaqen në përputhje me veprën e personit;
- fuqia që ka vepra e mirë për të fshirë gabimet, varet nga përsosja e veprës dhe nga realizimi i kushteve të pranimit të saj.

Marrim si shembull namazin: Ebu Davudi, në përmbledhjen e tij të haditheve përcjell transmetimin e Amar ibn Jasirit, sipas të cilit, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Ndodh që njeriu të kryejë namazin dhe t’i shkruhet vetëm një e dhjeta, apo një e nënta, apo një e teta e tij...”*. Në hadith përmendet edhe një e pesta, një e treta apo gjysma e namazit të personit. Pra, aq sa i pranohet njeriut namazi, aq është edhe fuqia e atij namazi, apo e asaj të mire për të fshirë gabimet. Siç thotë Allahu i Lartmadhëreshëm: **“... veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija...”**. (*Hud, 114*)

Pra, në saje të fuqisë së veprës vjen edhe fuqia e largimit të pengesave. Kësisoj edhe namazi i xhumasë përfshihet në këtë rregull të përgjithshëm, ashtu sikurse edhe namazet ditore. Argumente të tjera bëjnë të qartë faktin se njerëzit dallojnë shumë mes tyre në përsosjen e namazit të xhumasë. Në lidhje me këtë, në dy përmbledhjet me hadithe të sakta përcillet hadithi i Ebu Hurejrës, ku përmendet se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Ai që pastrohet ditën e premte, ashtu siç pastrohet prej xhunubllëkut (gjendjes së papastërtisë pas kryerjes së marrëdhënieve intime) dhe shkon në xhami, konsiderohet sikur ka bërë kurban një deve. Ai që shkon në çastet e dyta, konsiderohet sikur ka bërë kurban një lopë. Ai që shkon në çastet e treta, konsiderohet sikur ka bërë kurban një dash të majmë. Ai që shkon në çastet e katërta, konsiderohet sikur ka bërë kurban një pulë. Ai që shkon në çastet e pesta, konsiderohet sikur ka dhënë sadaka një vezë. E kur imami ngjitet në minber, melekët ndalen për ta dëgjuar dhikrin (hutben).”*

Pra, në saje të vlerave të xhumasë, që robi arrin t'i realizojë, është edhe fuqia e kësaj vepre për t'i shlyer gabimet dhe për të falur mëkatet. Nga kjo kuptojmë që, edhe në rast se besimtari tregon shpërfillje në përqendrimin e tij gjatë pesë namazeve dhe gjatë namazit të xhumasë, prapë Allahu ia hap dyert e amnistisë vjetore: *“Ramazani deri në Ramazanin tjetër i fshin mëkatet e vitit të shkuar, nëse njeriu ruhet nga mëkatet e mëdha.”*

Këtë parim të përgjithshëm fetar e trajton edhe Ebu Abas ibn Tejmije në vende të ndryshme në librat e tij. Ndër to përmendim librin “Minhaxh es-suneh”, ku në njërin prej temave, të titulluar: “Dhjetë shkaqet që eliminojnë dënimin e mëkatit”, ai flet për veprat e mira që i fshijnë gabimet. Gjatë shtjellimit të kësaj pike, Shejhul Islam Ibn Tejmije parashtron një pyetje: “Dikush mund të thotë: Nëse mëkatet më falen me pesë namazet, atëherë çfarë më shlyejnë e xhumaja dhe Ramazani?”

Shejhul Islam Ibn Tejmije e shtron këtë pyetje nga vetja e tij dhe në përgjigje të saj thotë: “Shlyerja dhe falja e mëkateve ndodh për veprat e mira të pranuar, - ky është parim, - kurse Allahu i Lartësuar i pranon veprat vetëm prej të druajturve. Shumica e njerëzve janë shpërfillës në vepra të mira, prandaj nga namazet ditore të pranuar fshihet një pjesë e mëkateve, pastaj nga xhumatë e pranuar fshihet një pjesë dhe nga Ramazanët e pranuar fshihet një pjesë tjetër.”

E vëreni se si ky kuptim, të cilin e përmend Ebu Abas ibn Tejmije, është i lidhur me fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Allahu pranon vetëm prej të druajturve.”** (Maide, 27)?

Përmendja e druajtjes këtu, a mos nënkupton se personit që nuk ruhet nga mëkatet e mëdha, nuk i pranohet asgjë? Jo, i tillë është interpretimi i *havarixhëve* për këtë ajet.

Mos vallë kuptimi i devotshmërisë këtu, është se personit që ruhet nga shirku, Allahu ia pranon çdo vepër? Kështu e interpretojnë *murxhitë*.

Atëherë, cili është interpretimi i saktë sipas *ehlu sunetit*? Citati **“Allahu pranon vetëm prej të druajturve.”** (*Maide, 27*) nënkupton se kush i druhet Allahut në një vepër të caktuar, Allahu do t’ia pranojë atë. Kështu, mund të ndodhë që një person të bëjë ndonjë mëkat të madh, por ai i druhet Allahut në një vepër të caktuar, të cilën Allahu ia pranon. Po ashtu, mund të ndodhë që një person tjetër të jetë më i mirë se i pari, por nuk i druhet Allahut në një vepër të caktuar, dhe si pasojë Allahu nuk ia pranon atë, edhe pse ia pranon veprat tjera në të cilat është druajtur.

Çfarë nënkupton “druajtja” në një vepër të caktuar?

Ajo nënkupton kushtet e pranimit të veprës. Që vepra të pranohet, ajo duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë e sinqertë; pra, të synohet kënaqësia e Allahut nëpërmjet saj;

- të jetë e qëlluar; pra, të jetë në harmoni me sunetin e Pejgamberit



Ky është interpretimi i saktë për vargun e njëpasnjëshëm të veprave shlyerëse të mëkateve dhe kjo është amnistia vjetore madhështore. Kur njeriu mediton mbi domethënien e saj, ai bëhet më punëtor dhe i druhet Allahut gjatë përpjekjes së tij për të agjëruar, sepse fuqia e fshirjes së gabimeve dhe e largimit të mëkateve të vogla nga regjistri i tij, varet nga pranimi i agjërimin.

Ndër kuptimet e tjera që mund të përmendim është edhe:

Definicioni kuranor i Ramazanit

Kurani e përshkruan Ramazanin në formën më të përsosur. Në fakt, ai tërheq vëmendjen. Çdo krijesë, materiale ose kuptimore, ka tipare me të cilat veçohet nga të tjerat. Prandaj, kur duam ta identifikojmë atë në formë të përgjithësuar, ne zgjedhim tiparin më të veçantë të saj ose diçka fisnike.

Për shembull:

- siujdhesa arabe: aty gjendet Asiri, Nexhdi, Hixhazi e Shemali. Mirëpo, kur duam ta përmendim atë me nderim, ne themi: “Si mund të ndodhë kjo në shtetin e dy *haremëve*?” Pra, zgjedhim termin “dy haremët”, ngase këto janë dy vendet më me vlerë në të, prandaj vendosim ta identifikojmë këtë krahinë me këto dy vende.

- mund të marrim si shembull Ebu Bekrin (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*). Ai kishte virtyte të shumta, por u njoh mbi të gjitha me emrin “es-siddik” (i sinqerti). Madje, sa herë që përmendet emri “es-siddik” në formë të shquar, mendja të shkon menjëherë tek ai. Përse

zgjedhim pikërisht sinqeritetin në këtë rast? Sepse sinqeriteti ishte virtyti më fisnik i tij. Vetë njeriu ka dëshirë të thirret me tiparin më fisnik që ka.

Allahu i Lartësuar, kur e përmend muajin Ramazan, e identifikon atë në formën më të përsosur dhe thotë: **“Muaji Ramazan është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”**. (Bekare, 185)

Shikoni se si Allahu e ka zgjedhur këtë muaj për zbritjen e Kuranit!

Në librin “Es-Sunen el-kubra” dhe në libra të tjerë përmendet një transmetim i Nesaiut, i përcjellë nga Ibn Abasi, ku thuhet: “Kurani ka zbritur i plotë në muajin Ramazan dhe ka qëndruar në qiellin e dynjasë. Kur Allahu donte të shpallte diçka, Ai e dërgonte atë nëpërmjet Xhibrilit.” Pra, e zbriti atë pjesë-pjesë sipas ndodhive.

Shikoni se si Allahu i Lartësuar ka bërë që tipari më fisnik i këtij muaji të jetë rrethanor kohe i zbritjes së fjalës më fisnike: Kuranit!

Kjo është vërtet një gjë e mrekullueshme! Allahu i Lartësuar fillimisht thotë: **“Muaji Ramazan...”**, pastaj e identifikon atë duke thënë: **“... është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”**.

Përse nuk e përshkroi Ramazanin me ndonjë tipar tjetër?

Përse Allahu zgjodhi që Ramazani të jetë rrethanor kohe për zbritjen e Kuranit?

Nuk ndodh që besimtarit t'i kalojë një referencë e tillë kuranore, e të mos i shkojë në mend kjo lidhje! Kurani lexohet edhe në muajt tjerë, por në Ramazan ka një veçanti dhe vlerë ndryshe. Kjo për

shkak se ai është muaji në të cilin zbriti vetë Kurani dhe Allahu e ka nderuar Ramazanin pikërisht për këtë fakt.

Një shembull tjetër që e përforcon këtë që thamë, është ai i Xhibrilit ﷺ, i cili ia mësonte Kuranin Pejgamberit ﷺ një muaj në vit. Pra, ai zgjodhi muajin Ramazan për ta mësuar Kuranin me Pejgamberin ﷺ, madje për çdo natë, deri në përfundim të Ramazanit. Në dy përmbledhjet më të sakta të haditheve përcillet hadithi i Ibn Abasit, ku thuhet se: *“Xhibrili takohet me Pejgamberin ﷺ për çdo vit në Ramazan, derisa mbyllet (muaji). Në këto raste, i Dërguari i Allahut ﷺ e lexonte Kuranin para atij.”* Kështu thuhet në versionin e hadithit që gjendet në sahihun e Muslimit. Kurse në sahihun e Buhariut thuhet: *“Takohet me të për çdo natë të Ramazanit dhe ia lexonte atij Kuranin.”*

Këtu lindin dy pyetje, që mendjes së muslimanit nuk i kalojnë pa i shtruar:

e para: Përse Allahu i Lartësuar na njofton me Ramazanin duke përmendur zbritjen e Kuranit: **“Muaji Ramazan është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”?** (Bekare, 185)

e dyta: Përse Xhibrili kishte zgjedhur muajin Ramazan, në mesin e gjithë muajve, për t’ia mësuar Kuranin Pejgamberit ﷺ? Përse nuk ia mësonte në muajin Dhulhixhe? Ose në muajin Muharrem? Përse zgjodhi pikërisht muajin Ramazan, e madje çdo natë të tij?

Kur besimtari mediton mbi këto dy pyetje, mahnitet tej mase për pozitën e Kuranit në muajin Ramazan dhe për faktin se ai nuk qenka vetëm Muaji i Agjërimit. Shpesh themi se Ramazani është Muaji i

Agjërimit, duke e lidhur atë vetëm me këtë adhurim, gjë që është e vërtetë. Por jo vetëm kaq. Në të vërtetë, muaji Ramazan është muaji i agjërimit dhe i Kuranit.

Ramazani karakterizohet me Kuranin, ngase Allahu na njofton me të duke thënë: **“Muaji Ramazan është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”** (Bekare, 185)

Gjithashtu, Xhibrili zgjodhi që ta mësonte Kuranin me Pejgamberin ﷺ në çdo natë të këtij muaji.

Transmetimet që na janë përcjellë nga brezat e parë, - siç i përmend Ibn Rexhebi në librin “Letaif el-mearif” (لطائف المعارف) dhe disa të tjerë që kanë shkruar rreth vlerës së muajit Ramazan, - tregojnë se çfarë përpjekjesh bënë brezat e parë për leximin e plotë të Kuranit disa herë brenda Ramazanit. Nga këto transmetime vërejmë se ata e lexonin Kuranin më shumë se në muajt e tjerë. Tërë vëmendjen ia kushtonin atij, duke i lënë punët e tjera mënjanë; madje, disa prej tyre linin mënjanë edhe punët që kishin lidhje me diturinë, - gje gjësisht diturinë fetare, - dhe i kushtoheshin vetëm Kuranit gjatë muajit Ramazan. Këto rrëfime për brezat e parë dëshmojnë për largpamësinë dhe mendjemprehtësinë e tyre. Ata i perceptonin me shumë saktësi kuptimet e teksteve fetare, pastaj i jetësonin ato në praktikë.

Ndër kuptimet e tjera që janë përmendur nëpër tekste fetare për muajin Ramazan, është edhe ai që mund t'i referohemi si:

Ditë të numëruara

Disa karakteristika të Ramazanit, që Allahu i Lartësuar i përmend në Kuran, muslimanit i japin ndjenja të përziera. Është një lëmsh ndjenjash i përzier me pasion, vëmendje dhe përdëllim për fundin që vjen shpejt. Allahu i Madhërishëm, për muajin Ramazan thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Ditë të numëruara...”**. (*Bekare, 183-184*)

Përse Allahu thotë këtu: **“Ditë të numëruara”**? Kuptohet, me termin “ditë të numëruara”, fjala është për muajin Ramazan. Ajeti është i qartë. Nuk është fjala për ditët e mbetura që janë përmendur në dispozitat e anuluar. Me “ditë të numëruara”, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, nënkuptohet vetë muaji Ramazan.

Kur përmendet numri, kuptohet se një gjë është e caktuar apo e kufizuar. Por kur Allahu Dijeplotë thotë për Ramazanin: **“Ditë të numëruara.”**, kuptohet se përveç faktit që është i kufizuar dhe i caktuar, ai ka edhe një kuptim shtesë për të cilin aludon konteksti; pra, qëllimi është **pakësimi**. **“Ditë të numëruara”**, d.m.th. “pak ditë”. Në një ajet tjetër thuhet: **“Ata e shitën Jusufin me një çmim të ulët, për pak grosh...”** (*Jusuf, 20*). Këtu, ajeti nuk ka kuptimin “e shitën për një sasi të numëruar ose të caktuar groshësh”, por “për një sasi të vogël të tyre”.

Përse është përzgjedhur fjala “të numëruara” për të aluduar sasinë e paktë? Është zgjedhur kjo fjalë për shkak se gjërat e pakta janë ato

që numërohen, kurse gjërat në sasi të madhe nuk numërohen, por llogariten si tërësi.

Kurani tregon se muaji Ramazan është me ditë të numëruara. Duke qenë kështu, muslimani e kupton domosdoshmërinë e interesimit për çdo çast të këtij muaji, ngase ai zgjat vetëm për disa ditë të numëruara. Vlera e madhe e tij është e kufizuar brenda atyre ditëve.

Ndër kuptimet e tjera të muajit Ramazan, që janë përmendur nëpër tekste fetare, është edhe:

Lidhja ndërmjet vlerës së veprës dhe kohës

Islami ka pesë shtylla, katër nga të cilat janë: namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi. Përse Allahu i Lartësuar ka zgjedhur që shtylla e agjëritit të përmbushet në Ramazan? Përse të mos përmbushet në një muaj tjetër?

Allahu Dijeplotë i ka privilegjuar kohët e veçanta nëpërmjet agjëritit. Rrjedhimisht, koha privilegjohet me agjërim, e agjëritit i rritet shpërblimi për shkak të privilegjit të kohës. Kjo ka shembuj të shumtë brenda fesë. Pra, ka një lidhje ndërmjet privilegjit të agjëritit dhe atij të kohës, që në këtë rast është Ramazani.

Si shembull të kësaj mund të përmendim: dita kur ka lindur Pejgamberi ﷺ është ditë me vlerë më vete; dita kur i Dërguari ﷺ u zgjodh pejgamber, është kohë me vlerë më vete. Në sahihun e imam Muslimit përcillet hadithi i Ebu Katade Ensariut, në të cilin thuhet

se Pejgamberi ﷺ u pyet njëherë rreth agjërimit të ditës së hënë. Si u përgjigj ai?

Ai tha: *“Ajo është dita kur kam lindur dhe dita kur jam zgjedhur pejgamber; ose “dita kur më ka ardhur shpallja për herë të parë.”* Pra, kur Pejgamberi ﷺ u pyet për agjërimin e ditës së hënë, - siç përmendet në sahihun e Muslimit, - ai përmendi një rast të veçantë: ditën e lindjes së tij dhe ditën kur u zgjodh pejgamber, apo kur i zbriti Kurani. Ku ka nder dhe privilegj më të madh sesa ky?

Begatimi i krijesave me lindjen e diellit të mesazhit islam, është mirësia më e madhe. Edhe kodrat janë krenuar me këtë shpallje madhështore. Njerëzit kanë nevojë për mesazhin që solli Muhamedi më shumë se ç’kanë nevojë për ushqim, pije, frymëmarrje, dritë e gjithçka tjetër. Shikoni se si agjërimi është gjëja më e qëlluar për privilegjimin e kësaj kohe! Kur Pejgamberi ﷺ u pyet për agjërimin e ditës së hënë, ai tha: *“Ajo është dita kur jam zgjedhur pejgamber.”*

Nga shembujt e këtillë është edhe *dita e Ashurasë*. Kjo ditë është e veçantë, siç përmendet në dy sahihët nga hadithi i Ibn Abasit. Sipas versionit të Muslimit, në hadith thuhet: *“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ erdhi në Medinë, ai i gjeti hebrejtë duke agjëruar ditën e Ashurasë. Ai ﷺ i pyeti: ‘Çfarë është kjo ditë që po agjëroni?’ Ata u përgjigjën: ‘Kjo është dita kur Allahu shpëtoi Musain e popullin e tij, dhe kur fundosi faraonin e popullin e tij. Musai e agjëroi këtë ditë në shenjë falënderimi, ndaj e agjërojmë edhe ne.’* Atëherë, Pejgamberi ﷺ tha: *‘Ne jemi më meritorë dhe më të afërt me Musain sesa ju.’ Kështu, ai ﷺ e agjëroi dhe porositi që ajo ditë të agjërohet.”*

TAKIMI I PARË

Dita e Ashurasë ishte e veçantë, pasi në të ndodhi një mirësi prej Allahut, ndaj dhe Musai e agjëroi atë në shenjë falënderimi. Njëlloj e agjëroi edhe Pejgamberi ﷺ në shenjë falënderimi. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se kohën e veçantë, Allahu e privilegjon me agjërim; njëkohësisht, agjërimi fiton privilegj për shkak të kohës së veçantë.

Këto ishin disa nga kuptimet dhe meditimet e Ramazanit. Ky ishte takimi i parë në të cilin folëm për “Konceptet e Ramazanit”.

Lusim Allahun të na i gëzojë zemrat tona me përjetimin e hënës së Ramazanit, të na privilegjojë me agjërim gjatë ditës dhe të na lëshojë mëshirën e Tij në namaz gjatë netëve të Ramazanit.

E lusim Allahun që të na mundësojë të kalojmë çdo çast të këtij muaji fisnik në shoqërinë e ajeteve të Librit të Tij.

Mëshira, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, Pejgamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Takimi i dytë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi më fisnikun e peygamberëve dhe të dërguarve, Muhamedin, Peygamberin tonë, si dhe mbi familjen e dhe shokët e tij!

Në takimin e parë folëm për disa koncepte dhe meditime të Ramazanit. Gjithashtu, ne mësuam kuptimin dhe domethënien e tyre. Ndër konceptet që përmendëm herën e kaluar, ishin: amnistia vjetore e Ramazanit, të kuptuarit e amnistisë ditore, javore dhe asaj vjetore; folëm për mënyrën se si Kurani na njeh me Ramazanin dhe se si e përshkruan atë me karakteristikën më të veçantë, pra që ai është muaji në të cilin ka zbritur Kurani. Më tej folëm për ditët e numëruara të Ramazanit si dhe përmendëm lidhjen që ekziston ndërmjet veçantisë së punës dhe veçantisë së kohës.

Në takimin e dytë me temë “Konceptet e Ramazanit”, do të flasim edhe për dy koncepte të tjera: ***i pari*** ka të bëjë me “sekretet e atribuimit hyjnor”, ndërsa ***i dyti*** mund të quhet si: “më shumë se shtatëqindfish”.

Sekretet e atribuimit hyjnor

Për çdo rit madhështor fetar kanë ardhur tekste hyjnore që flasin për vlerën, shpërblimin dhe pozitën e tyre tek Allahu i Lartësuar, por pozita e agjërimit është shprehur në një formë krejt ndryshe nga adhurimet e tjera. Kjo formë e të shprehurit është aq e veçantë, saqë shumë dijetarë janë mahnitur gjatë shpjegimit të tij. Bëhet fjalë për hadithin e Profetit ﷺ, ku thuhet: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të.”*

Çfarë do të thotë ky koncept? Çfarë nënkupton fakti që çdo veper e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, i cili është për Allahun?

A do të thotë kjo, se vetëm agjërimi qenka vepra që bëhet për hir të Allahut? Pa dyshim, kjo nuk është kështu, sepse çdo veper e mirë bëhet për hir të Allahut; përndryshe, ajo veper asgjësohet.

A mos vallë nënkuptohet me këtë, se veprat e mira kanë një dobi apo të mirë materiale të dynjasë për robin? Për shembull, namazi dhe ritet e haxhit i bëjnë dobi njeriut me aktivitetin e tyre trupor; ose zekati e pastron dhe e shton pasurinë. Nga ana tjetër, agjërimi është vetëm për Allahun në veçanti. Pra, në të nuk ka asnjë dobi materiale të dynjasë, apo jo? Nuk ka mundësi që të jetë kështu, ngase agjërimi i bën dobi trupit. Është si një lloj mburoje. Ndër dobitë më të mëdha trupore që sjell agjërimi, është nxjerrja e helmeve nga trupi.

Pra, ai është si çdo adhurim tjetër, nga i cili robi ka dobi edhe në aspektin material të dynjasë.

Mos ndoshta hadithi kudsij, ku thuhet: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të”*, ka kuptimin që është Allahu, Ai që shpërblen për të? Kjo për shkak se Ai Vetë thotë: *“Unë shpërblej për të.”* Natyrisht që jo. Nuk mund të ketë këtë kuptim, sepse është vetëm Ai që shpërblen për çdo adhurim dhe veprë të mirë. Pra, askush tjetër nuk ka kompetenca për të shpërblyer.

Apo mos ndoshta kuptimi i këtij hadithi është se agjërimi përbën veprën më të vlefshme, meqë Allahu thotë: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të”*? A është ky një argument që tregon se agjërimi është vepra më e mirë? Sërish, kjo nuk mund të jetë përgjigjja e duhur. Përse? Sepse tekstet hyjnore na bëjnë me dije se vepra më e mirë është namazi: *“... dhe dijëni se vepra juaj më e mirë është namazi.”*

Mos vallë kuptimi i saktë i hadithit është se në të gjitha veprat e tjera ka ndodhur që të adhurohet diçka tjetër pos Allahut? Pra, i është bërë sexhde putave, është bërë tavaf rreth varreve, është dhënë lëmshë për hir të idhujve, ndërsa agjërimi nuk është bërë për askënd tjetër pos Allahut. A është ky kuptimi i vërtetë i hadithit në fjalë? Sërish themi që jo. Ky nuk mund të jetë kuptimi i vërtetë i tij, sepse historia e popujve na dëshmon se sabeijtë, adhuruesit e yjeve dhe të tempujve agjëronin për hir të objekteve të tyre të adhurimit.

Atëherë, cili na qenka kuptimi i vërtetë i hadithit?

Ky hadith është madhështor. Kur dijetarët flasin rreth agjërimit, ata i japin shumë rëndësi këtij hadithi, sepse në të shihet qartë vlera e adhurimit në fjalë. Madje, Imam Buhariu, e ka vendosur këtë hadith në hyrje të kapitullit të agjërimit. Edhe Imam Ibn Rexhebi në librin “Letaif el-mearif”, për çdo stinë të vitit thur nga një kapitull, në të cilin përmend adhurimet e asaj stine. Kapitullin e agjërimit e hap me këtë hadith, pastaj përmend opinionet e ndryshme në shpjegimin e tij.

Pra, çfarë do të thotë fjala e Allahut Dijeplohtë në hadithin kudsij: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është Imi dhe Unë shpërblej për të?”* Çfarë kuptimi ka dhe çfarë dëshiron të thotë Allahu me këtë krahasim?

Ebul Hajr et-Talekani ka shkruar një libër me titull “Hadhair el-Kudus”. Këtë libër, ai e ka përpiluar pas hulumtimeve të thella. Në të ka përmendur koncepte të ndryshme, ndër të cilat edhe thënie për Ramazanin. Ai ka folur edhe për kuptimin e hadithit në fjalë. Ai radhit mendimet të dijetarëve që flasin për komentimin e këtij hadithi, që janë gjithsej rreth pesëdhjetë e pesë të tilla. Ndokush mund të çuditet nga ky numër, por mënyra e radhitjes së mendimeve tek dijetarët nuk është e njëjtë tek të gjithë. Një pjesë e tyre përdorin metodën e përgjithësimit, ndërsa një pjesë tjetër atë të detajimit.

Metoda e përgjithësimit përdoret atëherë kur gjenden pikat e përbashkëta mes opinionëve dhe në fund sillen një rezultat me dy, tre apo katër opinione.

Metoda e detajimit manifestohet atëherë kur nuk merren parasysh pikat dhe aspektet e përbashkëta të mendimeve, dhe dallimi më i vogël në opinion degëzohet e llogaritet si një opinion krejtësisht i ri. Kjo ndodh shpesh. Për shembull, Ibn Haxheri, kur flet për “kohën e pranimit të duasë në ditën e xhuma”, radhit rreth dyzet apo dyzet e tre opinione.

Pra, Ebul Hajr et-Talekani përmend pesëdhjetë e pesë mendime. Dijetarët kanë folur për librin e tij si dhe për mendimet që ai i përmend. Kur flet për et-Talekanin në librin “El-Fet’h”, Ibn Haxheri shprehet: “Thuhet se Ebul Hajri ka radhitur një numër të madh mendimesh rreth kuptimit të këtij hadithi”. Mirëpo, në fakt, Ibn Haxheri nuk ka pasur qasje të drejtpërdrejtë në librin në fjalë. Pas tij, Sujutiu e citon fjalën e Ibn Haxherit dhe thotë se ai vetë ka pasur mundësi që ta shohë librin drejtpërdrejtë. Këtë e ka përmendur në komentin e tij të librave të sunetit, por edhe në librin “Sunen Ibn Maxheh”. Pra, ky ishte libri i Ebul Hajr et-Talekanit dhe këto ishin përafërsisht opinionet e përmendura në të, të cilat arrijnë deri në pesëdhjetë e pesë syresh.

Sigurisht, ne nuk do t'i përmendim të gjitha këto mendime. Ibn Haxheri ka trajtuar dhjetë prej tyre dhe ka diskutuar për to, duke dhënë argumentin dhe kundërpërgjigjet për secilin mendim. Ne do të zgjedhim mendimet kryesore, e përkatësisht tre mendimet që transmetohen edhe nga dijetarët e brezit të selefëve.

Për vlerën dhe privilegjin e madh të muajit Ramazan, që nuk e posedon asnjë adhurim tjetër, ekzistojnë dy mendime të

transmetuara nga Imam Sufjan ibn Ujejne dhe një mendim tjetër nga Imam Ebu Ubejd el-Kasim ibn Selami, - njëri ndër krerët e dijetarëve të hadithit dhe sunetit në kohën e tij, - të cilin trajton në librin “Garib el-hadith”.

Mendimi i parë është i Sufjan ibn Ujejnes. Sipas këtij mendimi, të gjitha veprat e mira mund të përdoren si shpagim për zullumet dhe padrejtësitë mes robërve në Ditën e Kiametit, e si pasojë, ato do të pakësohen, përveç agjërimit.

Bejhekiu, në librin “Es-Sunen el-kubra” thotë: Ejub ibn Hasan Vasitiu transmeton: E kam dëgjuar një burrë tek e pyeste Sufjan ibn Ujejnen: “O Ebu Muhamed, fjalët që i Dërguari ﷺ i transmeton nga Zoti i vet, ku thotë: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të”*, çfarë kuptimi kanë?” Ibn Ujejne iu përgjigj: “Ky hadith është i mrekullueshëm dhe ndër hadithet më të qarta. Kur të vijë Dita e Kiametit, Allahu do ta marrë në llogari robin e Vet dhe me veprat e tij të mira do të shpaguejë padrejtësitë që ai ka bërë ndaj të tjerëve; pra, Allahu merr nga veprat e mira të robit për të shpaguezullumet e bëra ndaj të tjerëve, përveç agjërimit. Më pas, Allahu merr përsipër që ta shpaguejë pjesën e mbetur të padrejtësive dhe e fut robin e Tij në Xhenet me agjërimitin që ka bërë.”

Sufjani thotë se është pikërisht ky, kuptimi i këtij hadithi, pra se të gjitha veprat e mira të robit mund të përdoren për shpagimin e padrejtësive të bëra ndaj njerëzve, përveç agjërimit. Në rastin e këtij të fundit, Vetë Allahu merr përsipër që t'i shpaguejë ato padrejtësi

në vend të robit, të cilin e fut në Xhenet me agjërimin e tij. Sa i bukur është ky shpjegim! Në sahihun e tij, Buhariu përcjell hadithin e Ebu Hurejrës nga Pejgamberi ﷺ, të cilin e transmeton nga Allahu i Lartësuar, ku thuhet: “Secila vepër është shpagim, e agjërimi është i Imi dhe Unë shpërblej për të.”

Ky hadith na lë të kuptojmë se agjërimi nuk hyn në mesin e veprave që mund të përdoren si shpagim për padrejtësitë mes robërve. Edhe pse në hadith nuk përdoret ndonjë parafjalë përjashtimi, - pra Allahu nuk thotë: “Secila vepër është shpagim, përveç agjërimit”, - prapëseprapë kjo gjë është përmendur nëpër transmetime të tjera. Hadithi që gjendet në sahihun e Buhariut është i mjaftueshëm. Në të shihet qartë përjashtimi i agjërimit nga ajo që përmendet më lart.

Për këtë mendim, Kurtubiu ka thënë: “Më pëlqente kjo përgjigje deri kur më ra ndërmend hadithi i shpagimit, në të cilin agjërimi përmendet në radhën e veprave që përdoren për shpagim në botën tjetër.” Hadithi i shpagimit lidhet me pyetjen që sahabët i patën bërë të dërguarit duke i thënë: “O i Dërguar i Allahut, kush llogaritet si i falimentuar?” Ai u përgjigj: *“I falimentuar është ai që në Ditën e Kiametit vjen me namaz, lëmoshë e agjërim, e në anën tjetër e ka sharë njërin, e ka goditur tjetrin, ia ka ngrënë pasurinë një tjetri...”*. Në hadith thuhet: *“... i merren të mirat e tij për shpagimin e njërit, pastaj për shpagimin e tjetrit. Nëse të mirat i harxhohen para se t'i lajë borxhet, atëherë i merren të këqijat e të tjerëve dhe i vendosen këtij, e pastaj flaket në Zjarr.”* Kurtubiu thotë: “Kuptimi sipërfaqësor i këtij hadithi na

lë të kuptojmë se agjërimi ndan fat të njëjtë me veprat e tjera.” Kjo nënkupton se, në këtë aspekt, agjërimi nuk qenka i veçantë; pra, nuk është e vërtetë se shpërblimi i fituar nga agjërimi nuk përdoret për shpëtim të padrejtësive mes robërve. Kjo qasje bie ndesh me mendimin e Sufjan ibn Ujejnes.

Sipas mendimit të dytë, – të transmetuar po nga Sufjan ibn Ujejne, - robërve u është bërë i ditur shumëfishimi i shpërblimit të çdo vepre, përveç atij të agjërimin. Shpërblimin për këtë të fundit e di vetëm Allahu Dijeplotë.

Edhe ky është një opinion i rëndësishëm, por lidhet me një paragraf që do të përmendim më tej. Këto dy mendime transmetohen nga Imam Sufjan ibn Ujejne.

Mendimi i tretë është ai i Imam Ebu Ubejdit, njëri prej dijetarëve të hadithit, i cili kishte edhe njohuri të mirëfillta në gjuhë. Ky është edhe mendimi më i saktë. Sipas tij, hadithi në fjalë ka kuptimin që agjërimi është vepra më e pastër nga syfaqësia.

Por si është e mundur kjo?

Ne e dimë se ritet dhe veprat e mira në përgjithësi kryhen me gjymtyrë. Për shembull, kur njeriu do të falet, ai bie në sexhde e në ruku, pra kryen veprime me gjymtyrë. Kur do të kryejë ritet e umres apo haxhit, ai duhet të bëjë tavafin, sa’jin, qëndrimin në Arafat, ku secili veprim duhet kryer me gjymtyrë. Kur dëshiron të japë lëshim, ai duhet të zgjasë dorën e tij dhe të japë pasuri, gjë të cilën njerëzit e shohin; pra, duhet t’i kryejë të gjitha këto nëpërmjet gjymtyrëve. Në kësi rastesh, mund të ndodhë që zemra të anojë nga njerëzit dhe në të të depërtojë ndonjë pikë syfaqësie. Pra, veprat e

mira realizohen me veprime dhe fjalë, kurse agjërimi është vetëpërmbytje. Askush nga njerëzit nuk mund ta dijë se je duke e bërë këtë vepër pa treguar. Kjo vepër vetvetiu nuk përmban syfaqësi. Prandaj, në hadithin kudsij ku thuhet: “... përveç agjërimin, i cili është i Imi...”, nënkupton që vepra më e pastër nga syfaqësia është agjërimi. Ebu Ubejdi thoshte: “Të gjitha veprat realizohen nëpërmjet lëvizjeve, përveç agjërimin. Agjërimi nuk shfaqet tek njeriu, as në fjalët e as në veprat e tij.” Gjithashtu, për vërtetimin e kësaj, thuhej: “Gjendja e atij që lë ushqimin për shkak të ngopjes, është sikurse gjendja e atij që lë ushqimin për adhurim.” Me këtë kishin për qëllim gjendjen e jashtme. Gjendja e atij që lë ushqimin për shkak të ngopjes, është sikurse gjendja e atij që lë ushqimin për adhurim, sepse ndodh që njeriu ta lërë ushqimin për shkak se është ngopur, për shkak se do të evitojë ndonjë sëmundje, apo shtimin në peshë ose edhe për shkak të varfërisë. Shkaqet e lënies së ushqimit janë të shumta. Askujt nuk i shkon ndërmend se personi në fjalë është duke agjëruar, kurse për personin që falet, kryen umre apo haxh, si dhe për atë që jep lëmshë, dihet qartë se çfarë vepre është duke bërë. Ky është mendimi i tretë, gjegjësisht mendimi i Ebu Ubejdit, si dhe më i sakti nga të treja mendimet.

Këto janë mendimet rreth shpjegimit të vlerës së madhe të agjërimin, në prag të të cilit ndodhemi tani. O vëllezër! Ne jemi në prag të një adhurimi, për të cilin Allahu Dijeplohtë e i Madhërishëm, në këtë hadith kudsij përmend një privilegj dhe vlerë që nuk e posedon asnjë adhurim tjetër. Ai thotë: “*Të gjitha veprat që bën i biri*

i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi.” Allahu i Lartësuar, këtë vepër ia atribuon Vetes së Tij.

Prandaj, kur robit i kujtohet fjala e Allahut Dijeplohtë: **“Allahu pranon vetëm prej të druajturve.”** (Maide, 27), ai përpiqet që t’i druhet sa më shumë Allahut gjatë agjërimit të tij. Kjo për shkak se, në saje të lartësisë së gradës së këtij agjërimit tek Allahu, arrihet edhe ky privilegj dhe vlerë e madhe, ku Allahu ia atribuon këtë agjërimit Vetes së Tij.

Kjo ishte tematika e parë për të cilën donim të flisnim në takimin e dytë me temë “Konceptet e Ramazanit”.

Më shumë se shtatëqindfish

Sipas rregullit, shumëfishimi i veprave fillon nga dhjetë deri në shtatëqindfish. Kjo është bujaria e Allahut, i Madhëruar qoftë! Ai ua shumëfishon robërve shpërblimin e veprave. Njeriu bën një vepër të mirë, e cila i shumëfishohet. Për shembull: për shumëfishimin me dhjetë, Allahu Urtiplohtë ka thënë: **“Kush bën një vepër të mirë, i takon sa dhjetëfishi i saj.”** (*En’am, 160*) Njeriu bën një vepër, të cilën Allahu i Lartësuar ia shumëfishon dhjetë herë. Shumëfishimi me shtatëqind është përmendur në një nga shembujt e Kuranit, e njëra nga format e të shprehurit dhe argumentimit të Kuranit është edhe sjellja e shembujve. Në lidhje me këtë, Allahu thotë: **“I shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr, nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra...”** (*Bekare, 261*)

Allahu i Lartësuar ia shumëfishon robrit një vepër të vetme me dhjetë deri në shtatëqindfish, kurse për agjërimin, Ai e ka fshehur sasinë e shumëfishimit. Ky është vërtet një privilegj shumë i madh për këtë adhurim madhështor! Në hadithin që gjendet në të dy sahihët, e konkretisht në versionin e Muslimit, përmendet se Profeti ﷺ, duke transmetuar nga Zoti i vet i Plotfuqishëm, ka thënë: “Shpërblimi i çdo vepre të birit të Ademit shumëfishohet me dhjetë deri në shtatëqindfish. Allahu ka thënë: ‘... Përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të.’” Ai është një adhurim, për të cilin Allahu i Lartësuar na ka premtuar se do ta shumëfishojë me më shumë se shtatëqindfish; pra, një ditë agjërim na llogaritet sikur të kishim agjëruar, jo shtatëqind, por më shumë se shtatëqind ditë. Ky është vërtet një shpërblim i madh! Allahu nuk na e ka treguar numrin e shumëfishimit. Përse? Për të na bërë me dije se numrat e mëdhenj të shumëfishimit të shpërblimit nuk mund të llogariten e as të numërohen. Ai është Bujari i Lartmadhërishtëm.

Allahu i Lartësuar thotë se veprat e tjera i ka shumëfishuar me dhjetë deri në shtatëqindfish. Përse e thotë këtë? Dijetarët e shpjegojnë me faktin se agjërimi është një adhurim që ka në thelb durimin. Për këtë, Allahu Dijeplotë thotë: “**Vetëm durimtarëve u jepet shpërblimi pa masë.**” (*Zumer, 10*) Pa masë! Kur dijetarët flasin për komentimin e këtij ajeti, thonë se fjala është pikërisht për agjërimin. Ose, ky komentim mund të jetë nga ata me shembuj, gjë që brezat e parë e përdornin shpesh.

Tani, ne ndodhemi para një adhurimi madhështor, të cilin Allahu ia atribuon Vetes së Tij duke thënë: *“Të gjitha veprat që bën i biri i Ademit, janë për të, përveç agjërimit, i cili është i Imi.”* Allahu Bujar na tregon se shumëfishimi i shpërblimit të këtij adhurimi e tejkalon shtatëqindfishin. Ai thotë: *“Shpërblimi i çdo vepre të birit të Ademit shumëfishohet me dhjetë deri në shtatëqindfish, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të.”*

Prandaj, mjerë ne po na humbi ky adhurim madhështor! Të mos na ikë druajtja nga Allahu gjatë agjërimit! Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu pranon vetëm prej të druajturve.”** (*Maide, 27*)

Lusim Allahun të na mundësojë që ta arrijmë Muajin e Agjërimit, të na ndihmojë që t'i druhemi Atij gjatë këtij agjërimit dhe ta agjërojmë këtë muaj me bindje dhe llogaritje të shpërblimit.

Allahu është më i Dituri dhe më i Urti!

Mëshira, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, Pejgamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Takimi i tretë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi më fisnikun e peygamberëve dhe të dërguarve, Muhamedin, Peygamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Mirë se vini sërish, vëllezër të nderuar! Me lejen e Allahut, do të vazhdojmë takimet tona me temë “Konceptet e Ramazanit”.

Në dy takimet e kaluara kemi folur për amnistinë vjetore dhe për faktin se Ramazani është një e tillë. Kemi shpjeguar vargun e amnitive, mënyrën se si Kurani na njeh me Ramazanin, ditët e numëruara të Ramazanit dhe lidhjen e ndërsjellë mes vlerës së veprës dhe vlerës së kohës. Trajtuan gjithashtu edhe fshehtësitë e atribuimit hyjnor të agjërimit në hadithin kudsij, ku thuhet: “Shpërblimi i çdo vepre të birit të Ademit shumëfishohet me dhjetë deri në shtatëqindfish, përveç agjërimit, i cili është i Imi dhe Unë shpërblej për të”, si dhe folëm edhe për shpërblimin më shumë se shtatëqindfish.

Në këtë takim do të vazhdojmë të flasim për katër koncepte të tjera si dhe do të mësojmë kuptimin e tyre. Edhe konceptet në fjalë lidhen me muajin Ramazan. Ato janë:

- hyrja e veçantë, e rezervuar për në Xhenet;
- emërtimi unik;
- panorama përmyllëse;
- shenjat e përgatitjes.

Hyrja e veçantë, e rezervuar për në Xhenet

Të gjithë besimtarët bëjnë vepra të mira, me të cilat synojnë të arrijnë në Xhenet dhe të shpëtojnë nga Zjarri. Rruga për ta arritur këtë, është nëpërmjet veprave që janë degë të imanit, siç na ka treguar Pejgamberi ﷺ në hadithin e Ebu Hurejrës, të shënuar në dy përmbledhjet më të sakta të haditheve, ku thuhet: *“Imani ka gjashtëdhjetë e ca degë.”* Ky është versioni në përmbledhjen e Buhariut, të cilin e ka zgjedhur vetë ky i fundit. Ndërsa versioni tjetër, ku thuhet se: *“Imani është shtatëdhjetë e ca degë.”*, gjendet në sahihun e Muslimit. Buhariu ka zgjedhur versionin e parë për shkak të një dallimi të imët në zinxhirin e transmetuesve. Kur e diskuton zgjedhjen e Buhariut, Ibn Haxheri thotë: “Këtu vërehet qartazi shikimi i mprehtë i Buhariut.” Kjo është një tematikë e fushës së zinxhirëve të transmetimit, por e përmendëm kalimthi, ngase nuk është vendi i duhur për ta shpalosur. Ai që dëshiron të dijë më shumë në lidhje me këtë, le të kthehet te komentimet e këtij hadithi.

I Dërguari ﷺ ka thënë: *“Besimi është shtatëdhjetë e ca degë.”*

Cilat janë këto degë?

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për këtë në librat e tyre. Ndër të parët që kanë shkruar mbi këtë temë është njëri nga

imamët e shafiive, i quajtur Ebu Abdullah Halimiu. Ai ka shkruar një libër të mrekullueshëm rreth kësaj tematike, por e ka përpiluar me metodën e dijetarëve të fikhut. Librin e ka ndarë në disa kapituj, ku ka folur për degët e imanit. Në disa hyrje të kapitujve, ai ka folur për kuptimet e besimit, edhe pse brenda librit dallohet fryma e *esharizmit*.

Pas tij vjen Bejhekiu, i cili e lavdëron librin e Halimiut dhe ndjek rrugën e tij në panoramën e përgjithshme. Por ndryshe nga i pari, Bejhekiu i sjell tekstet me zinxhirë transmetimi sipas metodologjisë së dijetarëve të hadithit. Ai i ndan degët e imanit në kapituj, ku shënon hadithet dhe transmetimet përkatëse me zinxhirët e tyre. Ky është libri më përmbledhës mbi këtë temë. Në të gjen gjëra të mahnitshme në hadithe, transmetime dhe zinxhirë transmetimi. Libri në fjalë titullohet: “Shuab el-iman” (شعب الإيمان).

Të gjitha degët e imanit janë rrugë drejt Xhenetit si dhe shtigje drejt vendit të paqes. Xheneti, të cilin besimtarët duan ta arrijnë, ka disa dyer. Allahu Urtiplotë na bën me dije se dyert e Xhenetit janë tetë. Kjo gjë përmendet në dy përmbledhjet më të sakta të haditheve, e konkretisht në hadithin e Sehël ibn Sadit, ku përcillet se Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Në Xhenet janë tetë dyer.”.

Në tekstet fetare ka hadithe që flasin rreth këtyre dyerve dhe që përshkruajnë cilësitë, hapjen e tyre dhe melekët që i ruajnë ato. Këto hadithe e përmallojnë besimtarin për takimin me Allahun dhe me Botën e Përtejme.

Për shembull, ndër hadithet që flasin për këtë tematikë, është ai që thotë se, sa jemi ende në këtë dynja, dyert e Xhenetit hapen çdo të hënë dhe të enjte. Kjo ndodh me qëllim të nxitjes së besimtarëve për vepra të mira, siç përmendet në përmbledhjen e Muslimit me hadithe të sakta, ku Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Të hënave dhe të enjteve hapen dyert e Xhenetit dhe i falen mëkatet çdo rob i që nuk i bën shirk Allahut, me përjashtim të personit që ka armiqësi me vëllain e vet. Për këta të dy thuhet: “Prisni derisa këta të dy të pajtohen! Prisni derisa këta të dy të pajtohen! Prisni derisa këta të dy të pajtohen!”*

Kurse për sa i përket botës tjetër, personi i parë, të cilit do t'i hapet dera e Xhenetit, është i Dërguari i Allahut ﷺ. Në sahihun e Muslimit gjendet hadithi i Enes ibn Malikut, ku përcillet se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Në Ditën e Kiametit do të vij tek dera e Xhenetit dhe do të kërkoj të më hapet. Rojtari i Xhenetit do të më thotë: ‘Kush je ti?’ - ‘Jam Muhamedi’, - do t'i them. Ai do të më thotë: ‘Më është dhënë urdhri që të mos ia hap askujt derën para teje.’”* Pas të Dërguarit të Allahut ﷺ, te këto dyer do të vijnë besimtarët dhe melekët do t'ua hapin ato. Ata do t'i presin dhe do t'i përshëndesin për arritjen e sukseshme në siguri. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur (besimtarët) t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!”** (Zumer, 73)

Kjo është përshëndetja e melekëve për besimtarët, të cilët kanë ndjekur këto degë madhështore të imanit, derisa kanë arritur në dyert e Xhenetit.

Në këtë takim do të meditojmë rreth lidhjes mes degëve të imanit, që janë shtigje drejt Xhenetit, dhe dyerve të tij. Dyert e Xhenetit janë tetë, ndërsa degët e imanit janë shtatëdhjetë e ca syresh.

Allahu Dijeplotë, këtyre dyerve u ka vendosur emra të degëve më të veçanta të imanit. Ai ka zgjedhur që këto dyer të emërtohen në bazë të adhurimeve më kryesore. Emërtimi i një dere të Xhenetit sipas një vepre të caktuar bindjeje apo adhurimi, tregon për veçantinë që ajo ka nga veprat e tjera. Pra, nuk është e mundur që Allahu ta zgjedhë një adhurim, sipas të cilit të emërtojë një derë të Xhenetit, e që ai adhurim të mos jetë i veçantë.

Për shembull, sot shohim që xhamitë emërtohen me emrat e mbretërve e udhëheqësve, si një lloj nderimi për ta. E çfarë mund të thuhet për dyert e Xhenetit, të cilat emërtohen sipas adhurimeve përkatëse?! Kuptohet, ne nuk po diskutojmë këtu për dispozitën e këtyre emërtimeve, pra nëse ato lejohen apo jo; thjesht po bëjmë një krahasim për ta pasur sa më të qartë lidhjen ndërmjet nderimit dhe emërtimeve.

Këto dyer hapen në momentin kur besimtarët arrijnë aty, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Kur (besimtarët) t’i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t’u thonë: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!”** (Zumer, 73) Secila nga këto dyer është emërtuar sipas adhurimeve më kryesore, gjë që është nder dhe privilegj për të. Janë pesë dyer, emrat e të cilave janë përmendur në dy përmbledhjet më të sakta të haditheve (dy sahihët). Kurse tre emrat e tjerë janë

përmendur jashtë dy sahihëve, në hadithe të diskutueshme për sa u përket rrugëve të transmetimit.

Katër nga këta emra janë përmendur në hadithin e mësipërm, ku Pejgamberi ﷺ thotë: “.. *Ai që ka qenë i dalluar me namaz, thirret nga Dera e Namazit; ai që ka qenë i dalluar me xhihad, thirret nga Dera e Xhihadit; ai që ka qenë i dalluar me agjërim, thirret nga Dera e Rejanit; dhe ai që ka qenë i dalluar me lëmoshë (sadaka), thirret nga Dera e Lëmoshës.*” Pra, këta janë katër nga tetë emrat e dyerve të Xhenetit: Dera e Namazit, Dera e Xhihadit, Dera e Rejanit dhe Dera e Lëmoshës; një emër për namazin si adhurim, një për xhihadin, një tjetër për lëmoshën dhe një emër për agjërimin.

Emri i pestë i dyerve të Xhenetit është përmendur në dy sahihët tek hadithi i ndërmjetësimit, ku, teksa përshkruan disa çaste nga Dita e Gjykimit, Pejgamberi ﷺ tregon: “*Më thuhet: O Muhamed, ngrije kokën dhe kërk, që të të jepet! Ndërmjetëso, të të pranohet!*” Pejgamberi ﷺ e vazhdon përshkrimin e tij më tej dhe thotë: “*Unë e ngre kokën dhe them: ‘O Zot, umeti im! Umeti im!’ Ai më thotë: ‘O Muhamed! Ata që nuk do të merren në llogari prej umetit tënd, futi në Xhenet nga dera e djathtë e dyerve të Xhenetit, e ata do të jenë pjesëmarrës edhe në dyert e tjera, së bashku me njerëzit e tjerë.’*” Ky pra, është një tipar i derës së pestë. Ajo derë quhet “dera e besimtarëve që nuk do të merren në llogari dhe as nuk do të dënohen”.

Kurse emrat e tri dyerve tjera përmenden jashtë dy sahihëve. Për shembull, në librin “Sifetul-Xheneh” të Ibn Ebu Dunjasë, transmetohet se njëra nga dyert e Xhenetit quhet “Dera e atyre që

mbajnë lidhjet familjare”, pra e personave që i mbajnë lidhjet fafesisnore, që është një ndër adhurimet madhështore. Janë përmendur edhe disa emra të tjerë, e konkretisht në “Musnedin e Ahmedit” transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Për çdo kategori njerëzish që dallohen për një vepër të caktuar, ka një derë nëpërmjet të cilës thirren.”* Mirëpo, shumica e këtyre haditheve ose kanë një shkëputje në zinxhir, ose ndalen tek një sahab, ose janë të dobëta. Ndodh që të mos ketë asnjë mangësi në zinxhirin e transmetimit të një hadithi, por brenda tij nuk gjejmë përmendje të emrit të derës; pra, përmendet se kjo vepër është derë për në Xhenet, por nuk ka fjalë të drejtpërdrejta e të qarta për emrin e derës së Xhenetit.

“Dera Rejan”, që është emërtimi me të cilin veçohet njëra nga dyert e Xhenetit e që u hapet vetëm agjëruesve, është pa dyshim një privilegj dhe një vlerësim i madh për agjërimin si vepër adhurimi. Njeriu, teksa është në agjërim, gjatë drekës apo ikindisë, kur është duke pritur iftarin apo duke ngrënë syfyfyr, le të kujtohet se Allahu e ka veçuar një derë nga tetë dyert e Xhenetit posaçërisht për këtë adhurim.

Përfytyroni se çfarë ndikimi mund të ketë një përkujtim i tillë për shpirtin e besimtarit!

Veçimi i një dere për një adhurim të caktuar nënkupton se besimtari ka qenë i dalluar me atë adhurim dhe e ka vepruar shumë atë. Gjithashtu, robi mund të ketë pasur drojë të madhe ndaj Allahut gjatë këtij agjërimi dhe e ka përsosur atë; prandaj, ai është llogaritur si një nga anëtarët e asaj dere.

Të kalojmë tani tek një kuptim tjetër, që është: “emërtimi unik”.

Emërtimi unik

E vërejtët tashmë, se secila derë që përmendet në hadithin e dy sahihëve, është emërtuar sipas emrit të adhurimit në fjalë, përveç agjërimit. Dera e Namazit është emërtuar sipas adhurimit të namazit, Dera e Xhihadit sipas xhihadit dhe Dera e Lëmshës sipas lëmshës. Në dallim nga këto, dera e agjërimit nuk është emërtuar sipas veprës në fjalë, por i është vënë emri: “Dera Rejan”. Edhe pse në disa transmetime është përmendur se ajo quhet dera e agjërimit, por ajo njashtu quhet edhe “Dera Rejan”. Kjo është një veçanti në emërtim, e kjo veçanti e ka një domethënie.

E risjellim hadithin e mëparshëm ku thuhet: “... *Ai që ka qenë i dalluar me namaz, thirret nga Dera e Namazit; ai që ka qenë i dalluar me xhihad, thirret nga Dera e Xhihadit; ai që ka qenë i dalluar me agjërim, thirret nga Dera e Rejanit; dhe ai që ka qenë i dalluar me lëmshë (sadaka), thirret nga Dera e Lëmshës.*”

“**Rejan**” rrjedh nga paskajorja “er-rejj” (arb. الرّجّي) që nënkupton të kundërtën e etjes (gjegjesisht shuarjen e etjes). Shikoni se si këtu i është dhënë rëndësi përputhjes mes veprës dhe shpërblimit të saj. Allahu ka zgjedhur një emër për agjërimin, ku vetë emërtimi aludon shpagimin dhe shpërblimin e dedikuar. Njashtu, emri aludon edhe përsosurinë e shpërblimit për agjëruesin. Në vetë emërtimin e derës së dedikuar vetëm për agjëruesit është bërë me dije edhe shpërblimi i tyre. Kjo është një përsosje e begatisë fizike dhe asaj mendore; është

pjesë e përsosurisë së begatisë. Vetë emri i kësaj dere ia flladit zemrën agjëruesit. Kur besimtari agjërues e di se dera që i është dedikuar agjërimit quhet “Dera Rejan”, atij i kujtohet shuarja e etjes. Nuk është përmendur uria, ngase ajo që e mundon më së shumti agjëruesin është pikërisht etja.

Kalojmë tani te koncepti i tretë, që është **panorama përmbyllëse**.

Panorama përmbyllëse

Sigurisht, konceptet për të cilat folëm pak më parë, - pra që Allahu i ka kushtuar një derë të Xhenetit vetëm agjëruesve e që emërtimi i kësaj dere është unik, - janë të mahnitshme, por ajo çka të bën përshtypje më së shumti nga ky hadith, është “panorama e mbylljes së derës”. Kjo panoramë është e mrekullueshme si për atë që Allahu do t’ia mundësojë të hyjë nëpërmjet saj me agjëruesit, ashtu edhe për atë që do të privohet nga hyrja me ta.

Hadithi është vërtet mbresëlënë. Në sahihun e Buhariut, Sehli transmeton se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Në Xhenet është një derë që quhet Rejan. Besimtarët do të hyjnë në të Ditën e Kiametit. Askush tjetër, përveç tyre, nuk do të hyjë në të. Atë ditë do të thuhet: “Ku janë agjëruesit?” Ata ngrihen në këmbë dhe askush tjetër, përveç tyre, nuk hyn nëpërmjet saj.”* Pasi e bën të qartë dy herë, Pejgamberi ﷺ vazhdon: - *“Pasi ata të hyjnë, dera mbyllet dhe në të nuk hyn më askush tjetër.”*

Shprehja “*Pasi ata të hyjnë*” u referohet agjëruesve, të cilët hyjnë nëpërmjet Derës Rejan, e më pas dera “*mbyllet dhe në të nuk hyn më askush tjetër*”. Përfytyrojeni atë derë madhështore, Derën Rejan, që mbyllet me hapin e agjëruesit të fundit që hyn në të! Është një pamje mahnitëse! Është e tillë si për agjëruesin që Allahu e fut nëpërmjet asaj dera dhe e sheh atë duke u mbyllur pas tij, ashtu edhe për atë që pret shpërblimin, por që privohet nga hyrja nëpërmjet kësaj dera.

Kjo panoramë e nxit njeriun që t’i druhet Allahut gjatë agjërimin, në mënyrë që Ai t’ia pranojë atë, si dhe ta shprestojë agjërimin, me qëllim që të dallohet me të.

Konceptin e fundit për të cilin do të flasim sot, mund ta emërtojmë si “**shenjat e përgatitjes**”.

Shenjat e përgatitjes

Në dy sahihët, kur përmendet beteja e Tebukut, thuhet: I Dërguari i Allahu ﷺ e zhvilloi këtë betejë kur u poqën frutat dhe kur mbretëronte hija. Prandaj Allahu i Madhërishëm nuk arsyetoi askënd, por u kërkoi të gjithëve që të marrin pjesë në betejë. Ai thotë: “**Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë, dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!**” (*Teube, 41*). Pastaj Allahu i përmendi hipokritët dhe të tjerët që kërkuan të lirohen, të cilët ishin ftohur shpirtërisht dhe donin të shpëtonin nga pjesëmarrja në këtë luftë, ku Allahu i kishte thirrur të gjithë njerëzit. Kur i përmend

arsyet e tyre, Allahu thotë: **“Nuk do të të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre, ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit. E Allahu i di mirë ata që ruhen nga gjynahet. Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit dhe që zemrat e tyre dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.”** (*Teube, 44-45*). Më tej, Allahu ua hodhi poshtë argumentet dhe arsyetimet, duke ua nxjerrë në pah gjendjen, ku shihet mungesa e sinqeritetit në dëshirën e tyre për pjesëmarrjen në luftë përkrah të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai thotë: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...”** (*Teube, 46*). Pasha Allahun, ky është një argument që zbulon thellësitë e shpirtit të njeriut! **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...”**, por ata nuk janë përgatitur aspak. Çfarë nënkupton kjo? Kjo nënkupton se zemrat e tyre as që kanë pasur ndonjë pikë qëllimi për të marrë pjesë në luftë.

Ajeti: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty...”** nuk kufizohet vetëm për kapitullin e luftës, por ka edhe kuptim të përgjithshëm. Për këtë arsye, dijetarët e etikës islame e paraqesin këtë ajet në shumë kapituj të adhurimeve në dituri dhe vepra. Një ndër ta është Ibn Kajimi, i cili e përmend ajetin në fjalë në librin “Miftah darus-seadeh” (Çelësi i derës së lumturisë). Në këtë libër, ai ka shkruar kapituj të gjatë mbi krahasimin mes diturisë dhe pasurisë, duke përmendur dallimet mes tyre dhe duke sjellë argumente për vlerën e diturisë kundrejt pasurisë. Ndër gjërat që Ibn Kajimi konstaton brenda këtyre kapitujve të gjatë, është fakti se dituria shërben si pajim i udhëtarit drejt Allahut, gjë që argumentohet me

ajetin: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...”** (*Teube, 46*); pra, dituria është përgatitje për rrugëtimin drejt Allahut. Ibn Kajimi thotë: “Ai që synon një gjë, përgatitet mirë për të.” Ky është kuptimi i përgjithshëm i ajetit **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...”** (*Teube, 46*). Prandaj njeriu që gjendet në prag të Ramazanit, duhet të pyesë veten:

A e kam zemrën të mbushur me vendosmëri për të agjëruar?

A e kam zemrën të mbushur me vendosmëri për t’iu druajtur Allahut gjatë agjërimit?

A e kam zemrën të mbushur me vendosmëri dhe synim serioz për t’u falur natën dhe për t’i shfrytëzuar çastet e Ramazanit me lexim të Kuranit?

“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...” (*Teube, 46*).

Në shpirtin njerëzor duhet të shfaqen patjetër gjurmë. Për shembull, njeriu i sinqertë preokupohet për pakësimin e gjërave që mund ta shpërqendrojnë qysh para ardhjes së Ramazanit, si dhe mundohet t’i kryejë punët e tij pa nisur ky muaj . Përse vallë? Sepse ai dëshiron të jetë i lirë për adhurim gjatë atij muaji. Kurse njeriu i painteresuar mund të përgatitë ambientin për qëndrim nate në kotësi e në lojëra, apo mendon për programe televizive dhe seriale gjatë Ramazanit. Mes këtyre të dyve ka një dallim të madh.

Prandaj Allahu i Lartësuar thotë: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...”**. (*Teube, 46*) Njeriu që dëshiron diçka, përgatitet për të. Nuk na ka hije që të vijë ky muaj

fisnik e t'i gjejë zemrat tona në pakujdesi e të hutuara, duke mos u shqetësuar aspak. Zemrat tona duhet të trazohen nga mallëngjimi për muajin Ramazan. Ky është një argument për vullnetin e sinqertë në adhurimin e Allahut gjatë këtij muaji fisnik.

Këto ishin disa nga konceptet që do të trajtonim në këtë takim të tretë.

Shpresoj të takohemi sërish së shpejti, në dashtë Allahu, në takimin e katërt të këtij lloji, rreth temës “Konceptet e Ramazanit”. Allahu na dhëntë të gjithëve sukses drejt gjërave që Ai i do dhe që është i kënaqur me to!

Allahu është më i Dituri dhe më i Urti!

Mëshira, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, Pejgamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Takimi i katërt

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi më fisnikun e peygamberëve dhe të dërguarve, Muhamedin, Peygamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Do të vazhdojmë, me lejen e Allahut, takimet tona mbi “Konceptet e Ramazanit”. Në tre takimet e kaluara kemi folur për disa kuptime dhe koncepte që gjenden në tekstet fetare rreth agjërimit në Ramazan. Sot, në takimin e katërt, do të vazhdojmë me tre koncepte te reja, që janë:

- 1 – Bredhja e vazhdueshme;
- 2 – Provat e adhurimit;
- 3 – Ngushëllimi që zbut detyrimin.

Bredhja e vazhdueshme

Në popujt para nesh ka pasur njerëz që kishin shumë dëshirë ta adhuronin Allahun, ndaj afroheshin me Të nëpërmjet murgërisë. Ata i braktisnin kënaqësitë dhe ëndjet, duke shtypur instinktin dhe duke u veçuar nga njerëzit nëpër shtëpi dhe faltore, siç e ka përmendur Allahu i Lartësuar në suren Hadid, kur flet për të krishte-

rët: “... **Sa për murgërinë, Ne nuk ua urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë...**”. (*Hadid, 27*)

Shprehja “murgëri” rrjedh nga fjala “rahbe” (arb. رهبة), që do të thotë “drojë”. Përse vallë është marrë kjo shprehje nga kjo fjalë? Sepse një shkallë e tillë e asketizmit është rezultat i frikës, drojës dhe i shpresës së dobët (tek Allahu), ndaj robi e shtyn veten drejt vuajtjeve nga frika dhe droja e madhe që ndien.

Ndër llojet dhe ngjyrat e kësaj murgërie është edhe ajo që quhet “bredhje” (arb. السياحة). Këtë lloj adhurimi mund ta gjejmë në popujt e kaluar. Gjatë “bredhjes”, njeriu del në ambient të hapur dhe udhëton nëpër tokë pa ndonjë qëllim të caktuar, duke mos marrë asnjë furnizim për rrugë dhe, në të njëjtën kohë, duke iu mbështetur Allahut që Ai ta furnizojë kur ky ka nevojë.

Sufjan ibn Ujejne ka thënë: “Kur një njeri lë ushqimin, pijen dhe martesën, ai llogaritet si murg (i llojit të lartpërmendur).” Siç e përmend edhe Kurani, murgëria është një risi e shpikur. Transmetimet na bëjnë me dije se edhe “bredhja” në këtë kuptim, është një risi e shpikur. Në Islam nuk lejohet ky lloj i murgërisë. Abdurrezaku, në librin “El-Musanef” transmeton fjalët e Tavusit, i cili ka thënë: “Nuk ka murgëri në Islam.”

Në mesin e transmetimeve të përcjella nga Imam Ahmedi, - për tubimin e të cilave Halali (nxënësi i Imam Ahmedit) ka shëtitur botën, - ndodhet një tekst që flet për dispozitat e gruas. Imam Ahmedi është pyetur nëse është më i dashur një person që i dedikohet murgërisë dhe e adhuron Allahun, apo një tjetër që rri në

vendbanime (e që përzihet me të tjerët)? Ai është përgjigjur: “Murgëria nuk ka lidhje me Islamit, as me veprat e pejgamberëve e as me njerëzit e mirë.”

Gjithashtu, - në po të njëjtin libër e në të njëjtin vend, - Imam Ahmedi është pyetur: “Çfarë na thua për murgërinë, o Ebu Abdullah?” Ai është përgjigjur: “Jo! Porosis që njeriu të martohet dhe të frekuentojë xhamitë.”

Njashtu, Imam Ibn Tejmije na bën me dije se “bredhja” është pjesë e murgërisë. Në librin “El-iktidau”, ai ka thënë: “*Bredhja, e cila nënkupton daljen në një vend të shkretë pa kurrfarë objektivi, nuk është vepër e këtij umeti. Ajo është pjesë e murgërisë së sajuar.*”

Ebu Abdullah ibn Rushejiku ka qenë ndër nxënësit më të dalluar të Ibn Tejmijes. Për të, Ibn Kethiri thoshte: “Ai e njihte shkrimin e Ibn Tejmijes më mirë se vetë ai.” E njihte aq mirë, sa që ndonjëherë, kur Imam Ibn Tejmijes i ngatërroheshin disa dorëshkrime, ato i fillonte vetëm Ibn Rushejiku.

Kur iu kërkua që të veçonte titujt e shkrimeve të Ibn Tejmijes, ndër to, ai përmend një shkrim me titull “Parimet e bredhjes dhe kuptimi i saj në këtë umet”. Në librat e tij, ai e përmend shpesh këtë koncept. Por a është kjo, gjithçka rreth këtij koncepti? A është e vërtetë se vetëm te popujt e kaluar ka pasur murgëri dhe “bredhje” dhe se Allahu na e ka ndaluar murgërinë neve? Natyrisht që jo.

Sa herë që Allahu ia ndalon një gjë këtij umeti, Ai i legjitimon atij një gjë më të mirë:

- nëse është diçka e dëmshme, atëherë Allahu legjitimon të kundërtën e saj, që është e dobishme për ne;

- nëse është diçka e mirë, por e përzier me diçka të dëmshme, Allahu na legjitimon diçka të llojit të njëjtë duke e pastruar atë nga dëmi dhe e keqja.

Në vend të murgërisë dhe “bredhjes”, që praktikohet në popujt para nesh, - e që konsiderohet edhe si grada më e lartë e devotshmërisë për Allahun dhe e distancimit nga ëndjet, - Allahu na ka legjitimuar një gjë më të mirë: agjërimin. Ndër gjërat më interesante është fakti se Allahu e ka quajtur atë me emrin “sijaha” (bredhje). Në suren Teube thuhet: **“(Këta janë) ata që pendohen, e adhurojnë Allahun, e falënderojnë Atë, agjërojnë (“bredhin”), përkulen (në namaz), bien në sexhde (gjatë namazit), urdhërojnë vepra të mira, pengojnë të këqijat dhe u përmbahen kufijve të caktuar nga Allahu. Jepu lajmin e mirë besimtarëve!”** (Teube, 112)

Të gjithë dijetarët e brezave të parë janë të mendimit se me shprehjen “sijaha” (bredhje) në këtë ajet nënkuptohet agjërimi. Rreth kësaj janë transmetuar hadithe nga Pejgamberi ﷺ, si dhe fjalë të sahabëve e të tabiinëve. Madje, edhe Ibn Xherir Taberiu, që i njihnte më së miri mendimet e dijetarëve në shkencën e tefsirit, përmend vetëm një mendim nga dijetarët e brezave të parë rreth fjalës “sijaha” (bredhje) në këtë ajet, gjegjësisht se ka kuptimin e agjërimit. Pra, praktikuesit e “sijaha” në këtë ajet janë vetë agjëruerit.

Por ç’lidhje ka ndërmjet “bredhjes” dhe agjërimit?

Përse agjërimi u quajti “bredhje”, për të cilën e dimë mirë se ka qenë një praktikë e popujve para nesh dhe që Allahu e ka ndaluar?

Përse Allahu ka zgjedhur që t'i referohet agjërimit me shprehjen “bredhje”?

Ibn Atije në tefsirin e tij thotë: *“Allahu e ka përngjasuar agjëruesin me “bredhësin”, ngase “bredhësi” nuk interesohet për furnizim e as për ushqim, njëlloj si edhe agjëruesi, i cili e ndal veten nga ato. Kështu, agjëruesi dhe “bredhësi” janë të barabartë në abstenim dhe në jetën e mundimshme për shkak të mungesës së ushqimit.”*

Ez'heriu, njëri ndër dijetarët e gjuhës, ka thënë: *“Agjëruesi është përmendur me shprehjen “bredhës” (saih), ngjashëm me atë që bredh nëpër Tokë dhe që e adhuron Allahun pa furnizime. “Bredhësi” mbetet pa ushqim, njëlloj si dhe agjëruesi që abstenon nga ushqimi. Për shkak të kësaj ngjashmërie, agjëruesi është quajtur “saih” (bredhës).”*

Tani mund të kuptoni se emërtimi i agjërimit me shprehjen “bredhje”, - e cila, në popujt e kaluar ka qenë grada më e lartë e abstenimit për Allahun, - është një privilegj i mahnitshëm për agjërimin. Ky nuk është vetëm një emërtim spontan. Kjo mbart në vetvete vlerë, madhërim dhe nderim për agjërimin.

Ai që mediton mbi Kuranin, e kupton se:

- Allahu ka zgjedhur për agjërimin një emër të nderuar, gjegjësisht shprehjen “bredhje”, duke e dalluar atë nga ritet e tjera;

- Allahu ka zgjedhur një emër të veçantë për derën e agjërimit në Xhenet, e nuk e ka emërtuar atë sipas emrit të adhurimit, - si në rastin e Derës së Namazit apo Derës së Lëmoshës, - por e ka quajtur “Dera Rejan”.

Me të medituar këto gjëra, njeriu kupton se këto nderime janë mesazhe që ndikojnë në mbushjen e zemrës së besimtarit me madhësitinë e këtij adhurimi për Zotin e njerëzve.

Si është e mundur që besimtari t'i lexojë këto mesazhe të qarta nderimi, e pastaj t'i dalë nga mendja përulja ndaj Allahut gjatë këtij adhurimi madhështor?!

Ky adhurim e ka arritur këtë gradë në legjitimim, vlera, privilegje dhe emërtime. Si mund të ndodhë që njeriut t'i dalë nga mendja kjo gradë gjatë agjërimit?!

Koncepti i dytë, për të cilin do të flasim në këtë takim, quhet:

Provat e adhurimit

Pamja e gjakut të derdhur është e neveritshme për njeriun. Po t'i shfaqësh dikujt ndonjë pamje të të vrarëve në ekran apo nëpër rrjetet sociale, do ta shohësh t'i largojë sytë tutje instinktivisht. Përse? Sepse pamje të tilla janë me të vërtetë të shëmtuara për shpirtin e njeriut. Mirëpo gjaku i dëshmorit – shehidit, ka një pozitë tjetër tek Allahu. Për gjakun me të cilin është njiollosur trupi dhe rrobat e shehidit, Pejgamberi ﷺ ka urdhëruar që të lihet ashtu siç është. Buhariu përcjell hadithin e Xhabirit në ndodhinë e të vrarëve në Uhud, ku thuhet: “Ai dha urdhër të varrosen të përgjakur siç ishin, pa i pastruar.” Pra, i la trupat dhe rrobat e shehidëve siç ishin, ashtu të përgjakura, edhe pse besimtari i vdekur duhet larë. Larja e trupit është nderim, por ky veprim ishte një nderim edhe më i lartë për ta.

Përse vallë, Pejgamberi ﷺ i la ashtu të përgjakur?

Në sahihun e Buhariut gjendet hadithi i Ebu Hurejrës, i cili transmeton se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Çdo plagë që muslimani e merr në rrugën e Allahut, në Ditën e Kiametit do të paraqitet në formën e vet, - pra, në formë plage. - Kur të theret, do të rrjedhë gjak. Ngjyrën e ka si të gjakut, ndërsa aromën si të myshkut.”* Pra, asaj i vjen erë e këndshme.

Nëse ngjyra e gjakut të derdhur dhe pamja e plagëve të përgjakura ngjallin natyrshëm neveri në shpirtin e njeriut, atëherë përse i ka nderuar Allahu deri në këtë masë? Ai e ka ndaluar larjen e tyre, dhe në Ditën e Tubimit i sjell siç janë, por me një aromë të këndshme myshku, e cila ndihet gjithandej nëpër njerëz. Përse? Sepse ato janë gjurmë të adhurimit, bindjes dhe përruljes ndaj Allahut të Madhërishëm.

Shikoni se çfarë gjurmësh lë bindja! Allahu i Lartësuar i nderon edhe gjurmët e adhurimit tek robi i Vet, ndonëse këto gjurmë mund të jenë të neveritshme për vetë shpirtin e njeriut.

Ndër shembujt e këtij lloji është edhe tradita e njeriut për të lidhur kokën me çallmë ose për të vendosur ndonjë kapelë në kokë, për zbukurim, sepse, në thelb, lënia e kokës zbuluar nuk llogaritet si e tillë. Ndër zbukurimet më të mira është edhe parfumi dhe aromat e këndshme. Allahu Urplotë e ka bërë ligj që haxhiu, gjatë ritualit të haxhit, të mos e mbulojë kokën dhe të mos vendosë parfum, gjëra këto që i ka cilësuar si shkelje të ihramit. Në dy sahihët transmetohet hadithi i Ibn Abasit, i cili rrëfen: “Teksa një burrë po qëndronte në

Arafat me Pejgamberin ﷺ, ra nga shala e kafshës dhe theu qafën e vdiq. Pejgamberi ﷺ tha: *“Mbështilleni në dy rroba, por mos e parfumosni dhe mos ia mbuloni kokën, sepse në Ditën e Kiametit, Allahu do ta ringjallë duke kënduar telbijen.”*

Kur muslimani vdes, koka e tij duhet mbuluar dhe duhet parfumosur, ndërsa atij që vdes duke qenë me *ihram*, as i mbulohet koka e as parfumohet. Kjo për shkak se ato janë gjurmë adhurimi dhe Allahu i do, edhe pse për zemrën e njeriut është më e dashur e kundërta e tyre. Për shehidin, Allahu do që gjurmët e gjakut të tij t'i mbesin në trup; njashtu edhe për haxhiun do që të mos i mbulohet koka dhe të mos parfumohet. Përse? Sepse ato janë “prova të adhurimit” për njeriun. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për agjërimit. Në lidhje me këtë, Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Era e gojës së agjëruesit është më e dashur për Allahun sesa era e myshkut.”*

Këto gjurmë që mbesin tek agjëruesi për shkak të stomakut të tij të zbrazët, pra era e pakëndshme që del nga goja e tij e që është e neveritshme për njeriun, tek Allahu është më e këndshme sesa era e myshkut.

Koncepti i tretë është:

Ngushëllimi që zbut detyrimin

Kur na tregon për obligimin e agjërimit, Allahu i Lartësuar na jep edhe njohuri historike rreth tij. Kjo ka një domethënie madhështore. Allahu Dijeplotë thotë: **“O besimtarë! Ju është bërë detyrim**

agjërimi, ashtu siç u ishte bërë detyrim atyre para jush...” (*Bekare, 183*)

Fjalët e Tij **“Ju është bërë detyrim agjërimi”** tregojnë për një dispozitë, obligim dhe detyrim. Cila është arsyeja që, pas kësaj dispozite, Allahu shton edhe një fakt historik të popujve të kaluar? Përse thotë: **“ashtu siç u ishte bërë detyrim atyre para jush”**? Ky është një fakt historik, ndërsa norma obliguese qëndron te fjalët **“O besimtarë! Ju është bërë detyrim agjërimi”**. Pra, përse e pason këtë dispozitë me një fakt historik?

Kjo ka disa arsye. Allahu na tregon për diçka që na e lehtëson agjërimin. Kur një gjë e rëndë është e përhapur gjithandej, ajo bëhet më e lehtë. Me këtë pra, Ai po i ngushëllon zemrat duke thënë se ky detyrim nuk është një ngarkesë vetëm mbi këtë umet, por është një adhurim në të cilin kanë marrë pjesë edhe umetet e kaluara, çka do të thotë se në të nuk ka vështirësi. Gjërat e vështira nuk janë gjithëpërfshirëse. Ngarkesat dhe prangat janë të rralla për raste të veçanta të qortimit. Pra, ky është një përafrim i zemrave me këtë adhurim.

Fjalët e Allahut **“ashtu siç u ishte bërë detyrim atyre para jush”**, a kanë kuptimin që përngjasimi i përmendur në ajet nënkupton barazinë në detyrim, pra se të gjithë popujve u është obliguar agjërimi i një muaji në vit, siç na është bërë obligim edhe neve?

Përgjigjja është: Jo. Përngjasimi në këtë rast është bërë për thelbin e adhurimit, gjegjësisht për agjërimin, e jo për sasinë dhe mënyrën e agjërimit. Përdorimi i pjesës së ngjasimit është një gjë e përhapur

në gjuhën arabe. Për të ka shembuj të shumtë në tekstet fetare. Për shembull, Ibn Kajimi, në librin e tij me titull “Xhelaul-efham” flet për ngjasimin e lutjes për Pejgamberin ﷺ me lutjen për Ibrahimin ﷺ në uljen gjatë namazit (teshehud), ku thuhet: *“O Allah, mëshiroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç e ke mëshiruar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit.”*

Këtu ka lindur një pyetje tek shumë dijetarë: Si mund të jetë e ngjashme lutja për Muhamedin ﷺ me lutjen për Ibrahimin ﷺ, përderisa dihet se Muhamedi ﷺ ka qenë më i mirë se Ibrahim ﷺ? Ibn Kajimi e ka shpjeguar këtë gjë me disa diskutime të gjata, ku si shembull përmend edhe fjalën e Allahut të Lartësuar: **“O besimtarë! Ju është bërë detyrim agjërimi, ashtu siç u ishte bërë detyrim atyre para jush, që ju të druheni.”** (*Bekare, 183*). Më tej, Ibn Kajimi ka thënë: “Ngjasimi në këtë rast është në thelbin e agjërimit, e jo në formën, sasinë apo mënyrën e tij.”

Gjithashtu, kjo është sikurse fjala e Allahut Urtilotë: **“Ne të kemi sjellë ty Shpalljen, siç ia kemi sjellë edhe Nuhut dhe pejgamberëve pas tij.”** (*Nisa, 163*) Përngjasimi në këtë rast është me thelbin e Shpalljes, e jo me kuptimin e saj, pra që ajo çka i është shpallur Muhamedit ﷺ t’i jetë shpallur e njëjta në përmbajtje, sasi, apo mënyrë, siç u ishte shpallur pejgamberëve të mëhershëm.

Nga konceptet e thella të ajetit **“ashtu siç u ishte bërë detyrim atyre para jush”**, është edhe të vërtetuarit se agjërimi bën pjesë në radhët e adhurimeve madhështore. Kjo për shkak se ai ka qenë pjesë e të gjitha legjislatrave hyjnore, çka tregon se ky adhurim është i përshtatshëm për çdo kohë e për çdo vend. Gjithashtu, kjo tregon

edhe faktin se ai është i përshtatshëm dhe i dobishëm për vetë qenien dhe natyrën njerëzore. Përndryshe, Allahu nuk do ta bënte ligj të çdo populli që i ka ardhur Shpallja Hyjnore.

Kur besimtari mediton mbi natyrën e agjërimit dhe mbi dashurinë aq të madhe të Allahut për të, - saqë e ka bërë ligj për të gjithë popujt e mëhershëm, - zemra i mbushet plot me iman dhe përlulje për Allahun gjatë këtij adhurimi.

Këto ishin konceptet që kishim planifikuar të trajtonim në takimet tona. Shpresojmë të shihemi sërish në takime të tjera.

Allahu është më i Dituri dhe më i Urti!

Mëshira, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, Pejgamberin tonë, mbi familjen dhe shokët e tij!

Biografia e autorit

Biografia e autorit

Ibrahim Sekrani është i biri i Omer ibn Ibrahim Sekranit. Ai rrjedh nga një familje e njohur e fisit Temim. Ka lindur më, 04.04.1976. Studimet fillimisht i nisi në Fakultetin për Studimin e Karburanteve dhe Pasurive Nëntokësore, në Universitetin “Melik Fehd”. Pasi e përfundoi vitin e parë në këtë fakultet, e la për t’u transferuar në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin Islamik “Imam Muhamed ibn Sud” në Riad, ku edhe i përfundoi studimet bachelor. Ndërsa nivelin akademik master e arriti në degën e Politikave Fetare në Institutin e Lartë Juridik, pjesë e Universitetit Islamik “Imam Muhamed ibn Sud” në Riad. Pas kësaj, e arrin edhe një master tjetër në Britani, në Drejtësinë Ekonomike, pjesë e Juridikut, në Universitetin “Essex” në qytetin Colchester.

Ibrahim Sekrani në viti 2007 e kishte paraqitjen e tij të parë publike, përmes një shkrese me titull: “Synimet nga e folmja e të ‘qytetëruarve’”. Në këtë shkrim ai i bëri të qarta pikëpamjet e tij, si një njeri i cili pason Islamit e pastër burimor. Ky shkrim bëri bujë të madhe duke nxitur reagime të ashpra të atyre që përkrahin ideologjinë iluministe.

Në botën arabe njihet si një opinionist dhe analist i cili provokon një këndvështrim tjetër nga analiza shabllon për kulturën

perëndimore. Gjithashtu, përmes librave dhe shkrimeve të tij, ai trajton thelbin e çështjeve përmes trajtimit të tyre nëpërmjet Kuranit.

Është autor i disa librave, por deri në momentin që po flasim, të përkthyer në shqip janë: “Shtegu drejt Kuranit”, “Prehje kuranore” dhe “Shtigje të diturisë dhe besimit”.

Përmbajtja

Takimi i parë	7
<i>Amnistia vjetore</i>	8
<i>Çfarë nënkupton “druajtja” në një vepër të caktuar?</i>	12
<i>Definicioni kuranor i Ramazanit</i>	13
<i>Ditë të numëruara</i>	17
<i>Lidhja ndërmjet vlerës së veprës dhe kohës</i>	18
Takimi i dytë	21
<i>Sekretet e atribuimit hyjnor</i>	22
<i>Më shumë se shtatëqindfish</i>	30
Takimi i tretë	33
<i>Hyrja e veçantë, e rezervuar për në Xhenet</i>	34
<i>Emërtimi unik</i>	40
<i>Panorama përmbyllëse</i>	41
<i>Shenjat e përgatitjes</i>	42
Takimi i katërt	47

<i>Bredhja e vazhdueshme</i>	47
<i>Provat e adhurimit</i>	52
<i>Ngushëllimi që zbut detyrimin</i>	54
Biografia e autorit	61
Përmbajtja	63

